



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
¹: 611-24-9003-1-3-6/C787



K O N T R A T Ë /KORNIZË

Emri i Projektit: **Furnizim me uniforma per puntoret ne QKMF**

Numri identifikues: : **611-24-9003-1-3-6**, Datë: 16.10.2024; Nr. i arkivit; **400-01/ 50759**

PALET NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje “Punëdhënës”).

Agron Commerce SH.P.K., Zona Industriale, MITROVICË, përfaqësuar nga **ELMAR SYLA**, Drejtor (më tutje kontraktuese).

Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Furnizim me uniforma per puntoret ne QKMF**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimi të **furnizimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP². Periudha e kryerjes së punëve/shërbimeve dhe **furnizimeve** do të jetë deri në afatin : **30 dite**.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **7,860.00 €**; [*Shtatë mijë e Tetëqindë Gjashtëdhjetë EURO*]

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit te projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuuese. Afati i kryerjes së **furnizimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen Drejtoria e Shendetsisë.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **furnizimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **furnizimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblërjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve**/shërbimeve/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i shërbimeve

7.1 Garancioni një vite.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim,

korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërpërja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.



13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës, Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me menjëherë pas nënshkrimit.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	ELMAR SYLA
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.10.2024	Data:	16.10.2024
Vula:		Vula:	



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Drenasit**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **Agron Commerce SH.P.K.**, Zona industriale p.n Mitrovic Mitrovice
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: SIGURIMI I EKZEKUTIMIT: FURNIZIMI ME UNIFORMA PËR
PUNETORET NË QKMF
NR. IDENTIFIKUES: 611-24-9003-1-3-6/C787

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;


ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Shtate qinde e Tetedhjetë e Gjashtë 786.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **786.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **60 ditë prej 16.10.2024 deri më 15.12.2024**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyre automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.


Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data
16.10.2024

PARAMASA DHE PARALLOGARIA		PUNTORËT NË QKMF				FURNIZIMI ME UNIFORMA PËR	
	Përshkrimi i pozicionit	Nësi	Sasia	Cmimi	Shuma		
1.1	MANTILA PËR FEMRA (Personel shëndetësor) Mantili duhet të ketë ngjyrë të bardhë me krahe të gjatë me jake ruse (Russian collar,kam prifti) ka një fiksime të mirë me kopsa të fshehura. Tre gjepa përpara,një sipër majtas dhe 2 poshtë. Të gjithë gjepat të jenë të forcuar me qepje të dyfishtë. Përbërja:Polister 65%,pambuk 35%. Në anën majtë në gjokse të ketë një xhep ku të jetë e vendosur logoja e QKMF-S(Embleme jo e printuar) dhe mishkrimi DR. Hafir Shala-Drenas . Po ashtu etiketa me perberje 65% polister 35%pambuk. Secili mantili ta ketë etiketen e perberjes se materialit, Mostrat e obligueshme.	palë	100	11.00	1,100.00		
1.2	PANTOLLA PËR FEMRA (Personel shëndetësor) Pantollat duhet të ketë përmbajtje minimumi prej 35%pamuk,Polister 65%.Me lidhse (ushkur) dhe elastik për gjatë tërë pjesës së qepur të belit. Me 2 gjepa në të 2 anët të forcuar dhe të qepura 2 here dhe një xhep mbrapa në pjesën e majtë. Pjesa e lëvizshme duhet të jetë nga brenda e qepur me astar dhe po ashtu etiketa me perberje 35%pamuk,Polister 65%.Secili palë e pantollonave duhet ta ketë etiketen e perberjes se materialit të ngjitura , mostrat e obligueshme.	palë	100	11.00	1,100.00		

Shënim: Nëse shënimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme, tërësi e punës duhet të kryhet në mënyrë të përcaktuar.

1.3	KLLOMPE PËR FEMRA (Personel shëndetësor) Klompet medicinale të jenë të punuara me material rezistent ndaj lageshtisë dhe të ftoftit. Në pjesën e poshtme të jenë nga goma e butë jo e rrëshqitshme. Të jenë të punuara nga materiali i lekurës me vrima me ajrosje, ngjyra e bardhë, baza të jetë me gomë të fort sipas anatomisë së shpirtës. Secila të ketë të shënuar përberjen e materialit dhe certifikatat. Të jenë të licencuara nga CE EN-ISO 20347/2012, OB-ESRC, mostrat e obligueshme.	palë	100	19.00	1,900.00
1.4	MANTILA PËR MESHKUJ (Personel shëndetësor) Mantili duhet të ketë ngjyrë të bardhë me krahë të gjatë. Mantili me jake ruse (Russian collar, kam priftijka një fiksime të mirë me kopsa të fshihura metalike. Tre gjepa përpara, një sipër majtas dhe 2 poshtë. Të gjithë gjepat të jenë të perforuar me qepje të dyfishit. Përbërja: Polistër 65%, pambuk 35%. Në anën majtë në gjokse të ketë një xhiep ku të jetë e vendosur logoja e QKMFS (Embleme jo e pritur) dhe mishkrimi DR. Hafir Shala-Drenas. Po ashtu etiketa me përberje 65% poliestër 35% pambuk. Secila palë e mantillave duhet ta ketë etiketën e përberjes së materialit. Mostrat e obligueshme.	palë	50	11.00	550.00

5 Kufiz

SHKËRIM
04/11/2020

2020

1.5	PANTOLLA PËR MESHKUJ (Personel shëndetësor) pantollat duhet të ketë përmbajtje minimumi prej 35%pamuk,Polistër 65%.Me lidhse (ushkur) dhe ilastik për gjatë tërë pjesës së qepur të belit.Me 2 gjepa në të 2 anet të perforcuar dhe të qepura 2 here dhe një xhep mbrapa në pjesën e majtë.Pjesa e ijeve duhet të jetë nga brenda e qepur me astar dhe po ashtu etiketa me perberje 35%pamuk,Polister 65%. Secili manill ta ketë tiketen e perberjes së materialit të ngjitur , mostrat e obligueshme.	palë	50	11.00	550.00
1.6	KLLOMPE PËR MESHKUJ (Personel shëndetësor) Klompet medicinale të jenë të punuara me material rezistent ndaj lagështisë dhe të ftoftit.Në pjesën e poshtme të jenë nga goma e butë jo e mëshqishme.Të jenë të punuara nga materiali i lekurës me vrima me ajrosje,ngjyra e bardhë,baza të jetë me gomë të fort sipas anatomicisë së shputës.Secila të ketë të shenuar perberjen e materialit dhe certifikatat. Të jenë të licencuara nga CE En-ISO 20347/2012,OB-ESRC,mostrat e obligueshme.	palë	50	19.00	950.00
1.7	UNIFORMA PËR SHËRBIME EMERGJENTE :Bluza të jetë me jakë (jake ve) duhet të jetë me minge të shkurër me 3 gjepa (2 në pjesën e poshtme dhe një në anën e majtë)me ngjyrë të kuqe,në anën majtë në gjokse të ketë një xhep ku të jetë e vendosur logoja e shërbimit emergjent,dhe në pjesën mbrapa në shpinë të jetë e vendosur logoja e QKMF dhe mbishkrimi Shërbimi i urgjencës dhe logoja e QKMF (Embleme jo e printuar) dhe mbishkrimi DR.Hafir Shala-Drenas .Dhe në gjepë .Përberja:Polistër 65%,pambuk 35%.Pantollonat duhet të jenë me ngjyrë të kuqe me 2 gjepa në pjesën e poshtme dhe 2 të gjatë. Po ashtu materiali me perberje 90 % liker dhe 10% polister.Jakne verore të përbeje fosfore 5cm me 3 gjepa (2 në pjesën e poshtme dhe një në anën e majtë) dhe vendosja e logos,dhe në pjesën mbrapa në shpinë të jetë e vendosur logoja e QKMF dhe mbishkrimi Shërbimi i urgjencës (Embleme jo e printuar) dhe mbishkrimi DR.Hafir Shala-Drenas . Polister 65%,35% pambuk.Secila të ketë të shenuar perberjen e materialit dhe certifikatat ,mostrat e obligueshme.	palë	45	22.00	900.00

1.8	Kepuc-Patika per emergjenc. Te jene te lekures 100%, Secila te kete te shenuar perberjen e materialit dhe certifikatat ,mostrat e obligushme.	copë	45	18.00	810.00
				Gjithesaj:	7,860.00

PLANI DINAMIK 30 DITE

SOARIM:Operatori duhet të marrë gjitha masat e uniformave për të gjithë të punsuarit në kudoqin pasore shëndetësor si dhe numrat e kilometreve medicinale,patkave per emergjenc.Kompanit ofertuese janë të obliguar që të sjellin mostrat(mantilla,pantolla,kilompet,Uniformat per sherbime emergjente, Kepuc-Patika per emergjenc medicinale për të dy gjinitë) pra katalogun e produkteve se bashku me oferten. Kompania futese të mundësoj ngririmin e uniformes në qfare do resti te mundshëm.